

**Nr. Prot. 029/B/20**

**VENDIM Nr. 1597**

**Për**

**Miratimin e**

**“Rregullores për Qasjen e Hapur në Lakun Lokal ose pjesë të tij”**

Në mbështetje të nenit 1, nenit 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 9, paragrafi 3.3), nenit 10, paragrafi 4), nenit 33, nenit 34, neni 36, neni 37, nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- 1) z. Nijazi Ademaj, Anëtar
- 2) z. Hazir Hajdari, Anëtar
- 3) z. Bahri Anadolli, Anëtar, dhe
- 4) z. Shqiprim Pula, Anëtar.

në mbledhjen e 54-të me radhë të mbajtur më datë 24 Qershor 2020, pas shqyrtimit të draft Rregullores për Qasjen e hapur në Lakun Lokal ose pjesë të tij, komenteve të operatorëve, dhe rekomandimit të Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamentit Ligjor (DL), vendosi si më poshtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet ‘Rregullorja për Qasjen e Hapur në Lakun Lokal ose pjesë të tij’.
- II. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Neni 1 i Ligjit specifikon qëllimin e Ligjit si në vijim:

*“Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.”*

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: *“Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”*

Në përputhje me nenin 82 të Ligjit, draft rregullorja para aprovimit ka kaluar në procedurën e konsultimit publik, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Rregullorja përcakton kërkesat për qasjen e hapur në lakun lokal ose një pjese të tij, rregullat teknike dhe operative për rrjetin e komunikimeve elektronike për qasje në të gjithë ose një pjesë të lakut lokal, informatat që duhet të përfshihen në Ofertën Referente (OR) të qasjes së hapur në lakun lokal dhe nivelin e detajeve të kërkuara.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

**Prishtinë, 07/07/2020**

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

#### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Ofruesve të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike,
- Departamentit Ligjor,
- Arkivës së Autoritetit.